

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-227-236/14

Prishtinë, 19 shkurt 2016

Në çështjen juridike të:

A. K.

Përfaqësuesi: B. SH. L., .

Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë

kundër.

Trashëgimtar(ët) e **M. P.**

Përfaqësuesi: B. P.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/227/20114 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA32127, KPA32129, KPA93319, KPA93320, KPA93321, KPA93322, KPA93323, KPA93326, KPA93328 dhe KPA93329 të datës 13 Mars 2014 pas seancës gjyqësore të mbajtur më 19 shkurt 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga A. K., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-227/2014, GSK-KPA-A-228/14, GSK-KPA-A-229/2014, GSK-KPA-A-230/2014, GSK-KPA-A-231/2014, GSK-KPA-A-232/2014, GSK-KPA-A-233/2014, GSK-KPA-A-234/2014, GSK-KPA-A-235/2014, dhe GSK-KPA-A-236/2014 që kanë të bëjnë me lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA32127, KPA32129, KPA93319, KPA93320, KPA93321, KPA93322, KPA93323, KPA93326, KPA93328 dhe KPA93329 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-227/2014.
2. Ankesat e paraqitura nga A. K. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/227/20114 sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA32127, KPA32129, KPA93319, KPA93320, KPA93321, KPA93322, KPA93323, KPA93326, KPA93328 dhe KPA93329 të datës 13 Mars 2014, refuzohen si të pa bazuara
3. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/227/20114 sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA32127, KPA32129, KPA93319, KPA93320, KPA93321, KPA93322, KPA93323, KPA93326, KPA93328 dhe KPA93329 të datës 13 Mars 2014 vërtetohet.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 23 Mars 2007, M.P., (në tekstin e mëtejme: Pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon pronësinë e ngastrave kadastrale 90/1 dhe 91/1, Zona kadastrale Jahoc, komuna e Gjakovës dhe kthimin e posedimit.
2. Në këto kërkesa ai kishte theksuar se pronat e kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99.
3. Për të mbështetur kërkesat e tij kishte dorëzuar në Agjencinë Kosovare të Pronave dokumentet vijuese:
 - Fleta poseduese nr.1013 lëshuar nga Departamenti i kadstrit dhe gjeodezisë i komunës së Gjakovës që dëshmon se pala përgjegjëse në ankesë është pronar i ngastrave 90/1 me kulturë kullosë, me sipërfaqe prej 1.27.15 ha dhe 91/1, kulturë arë e klasit të dytë me sipërfaqe prej 5.99.99 ha.
 - Deklaratë datës 23 Mars 2007 me të cilën pala përgjegjëse në ankesë bënë me dije se ka pasur një marrëveshje për ndarjen e ngastrave dhe për shitjen e tyre me Agjencinë private për qarkullimin e palujtshmërive “K.”, pronarë i të cilave është A. K. (pala ankuese)
 - Letërnjoftim lëshuar me 31 Mars 1982 nga Sektori i punëve të brendëshme në Arandëlovac të Serbisë.

- AKP-ja ka gjetur fletën poseduese me ngastrat 90/1 dhe 91/1 të ndryshuar në CDP (ndarja kadastrale e parcelave) të re nr. 00981 - e rëndësishme për sa i takon pronave të kërkuara në këtë rast - me ngastrat nr. 90/1, 91/34; 91/35; 91/36, 91/37, 91/38, 91/39, 91/55, 91/56, 91/57, 91/60 dhe 91/61. Këto ngastra kadastrale të kërkuara nga pala përgjegjëse në ankesë e që ndodhen në zonën kadastrale të Piskotë në vendin e quajtur “Jahoc. Ato janë të regjistruara në emrin e M. P.si më poshtë:

Numri i ankesës dhe numri i lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-227/14 (KPA32127)	Ngastra nr. 90/1, në vendin e quajtur “Jahoc”, me sipërfaqe prej 0.08.14 ha
GSK-KPA-228/14 (KPA32129)	Ngastra nr.91/34 në vendin e quajtur ” “Jahoc me sipërfaqe prej 0.13.03 ha
GSK-KPA-A-229/14 (KPA93319)	Ngastra nr. 91/35 në vendin e quajtur “Jahoc ë me sipërfaqe prej 0.13.48 ha
GSK-KPA-A-230/14 (KPA393320)	Ngastra nr. 91/36, në vendin e quajtur “Jahoc me sipërfaqe prej 00.13.30 ha
GSK-KPA-A-231/14 (KPA93321)	Ngastra nr. 91/37, në vendin e quajtur ” “Jahoc me sipërfaqe prej 00.13.57 ha
GSK-KPA-A-232/14 (KPA93322)	Ngastra nr. 91/38, në vendin e quajtur ” “Jahoc me sipërfaqe prej 0.14.12 ha
GSK-KPA-A-233/14 (KPA93323)	Ngastra nr. 91/39, në vendin e quajtur ” “Jahoc me sipërfaqe prej 0.14.76 ha
GSK-KPA-A-234/14 (KPA93326)	Ngastra nr. 91/55, 91/56 dhe 91/57në vendin e quajtur ” “Jahoc me sipërfaqe prej 0.60.00 ha
GSK-KPA-A-235/14 (KPA93328)	Ngastra nr. 91/60 në vendin e quajtur ” “Jahoc me sipërfaqe prej 00.02.00 ha

GSK-KPA-A-236/14 (KPA93329)	Ngastra nr. 91/61, në vendin e quajtur ” “Jahoc me sipërfaqe prej 00.27.87 ha
--------------------------------	---

4. Më 22 Korrik 2008, 12 Nëntor 2013 dhe 6 Shkurt 2014, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur shenjat ne pronat e kërkuara. Sipas raportit të Notifikimit të datës 12 Nëntor 2013 Agjencia ka konstatuar se prona është identifikuar saktësisht përmes ortofotos dhe GPS kordinatave.
5. A. K., pala përgjegjëse në ankesë, ka marrë pjesë në procedurë duke paraqitur dokumente. Ai pretendon se pala përgjegjëse në ankesë ka shitur pronat e kërkuara përmes tij si përfaqësues.
6. Në mbështetje të pretendimeve të tij pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur dokumentet si vijon:
 - Autorizim i datës 09 tetor 2004 Ref.no.II 463/2004 I vërtetuar në Gjykatën Komunale të Kragujevcit në Serbi, përmes së cilit pala përgjegjëse në ankesë e ka autorizuar Agjencinë për Patundshmëri ”K.” nga Peja përkatësisht pronarin e saj, A. K. për të ndërmarrë të gjitha veprimet për matjen, ndarjen fizike të ngastrave të kërkuara 90/1 dhe 91/1 në sipërfaqe të përgjithshme prej 07.27.14 ha të regjistruar në Fletën Poseduese nr. 1013 në zonën kadastrale Jahoc , Komuna e Gjakovës.
 - Vendim i datës 25 prill 2005, Ref no.952-02-347/04 Lëshuar nga Drejtorati kadastral i komunës së Gjakovës për aprovimin e kërkesës së pala përgjegjëse në ankesë për ndarjen fizike të ngastrës 90/1 dhe 91/1 dhe krijimin e ngastrës së re. Në mesin e këtyre parcelave janë edhe parcelat në të njëjtën skemë të paraqitur këtu në paragrafin 3.
 - Deklaratë për shitjen vullnetare të pronës së paluajtshme për pranimin e çmimit të dakorduar të shitblerjes, të datës 25 maj 2005 Ref.1394/2005. Pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se ka shitur vullnetarisht ngastrën kadastrale 91/46 përmes A.K. Po ashtu ai deklaroi se ka pranuar çmimin e shitblerjes të caktuar nga ai dhe për të tërhequr kërkesat tjera apo anulimin e kontratës së shitblerjes si dhe deklaratat tjera që dëshmojnë shitjen e ngastrave që nuk janë objekt shqyrtimi i Vendimit të KPCC-së e rrjedhimisht as i ankesës.
 - Autorizim i datës 27 maj 2005 Ref.no.1928/2005 i vërtetuar në Gjykatën Komunale të Mitrovicës përmes së cilit pala përgjegjëse në ankesë ka autorizuar Agjencinë për Patundshmëri ”K” nga Peja përkatësisht pronarin e saj A K për të shitur ngastrën nr. 91/45 dhe për të finalizuar transaksionin.
 - Autorizim i datës 25 korrik 2005 Ref.no.2711/2005 I vërtetuar në Gjykatën Komunale të Mitrovicës përmes së cilit PK ka autorizuar Agjencinë për Patundshmëri ”K” nga Peja përkatësisht pronarin e saj A K për të shitur ngastrën nr. 91/51 dhe për të finalizuar transaksionet.
 - Padi civile e palës përgjegjëse kundër palës ankuese për pagesë borxhi në vlerë prej 155.00.00 euro e dorëzuar në Gjykatën e Gjakovës me 18 dhjetor 2006.

- Aktvendim i drejtorisë për kadastër – komuna e Gjakovës nr. 952-02-347/04 datë 25 Prill 2005 me të cilin aprovohet ndarja fizike e parcelave të kërkuara.
 - Dokuemnete të tjera të ndryshme (kontrata, autorizime dhe deklarata të palës përgjegjëse në ankesë) të përbledhura, në lidhje me shitjen e ngastrave të cilat nuk janë objekt shqyrtimi i kërkesave të përmendura në skemën e këtushme dhe të cilat nuk janë objekt shqyrtimi i KKPK-së për sa i takon qënjes objekt i shqyrtimit të ankesës në këtë lëndë.
7. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së, fleta poseduese me ndryshime (pas ndarjes) dhe dokumentet e parashtruara nga pala përgjegjëse janë verifikuar pozitivisht.
 8. KKPK-ja në vendimin e saj KPCC/D/A/227/2014 i datës 30 Mars 2014 konfirmon se paraqitësi i kërkesës, pala përgjegjëse, ka dëshmuar se ka pronësi të pronës së kërkuar në kërkesat KPA32127, KPA32129, KPA93319, KPA93320, KPA93321, KPA93322, KPA93323, KPA93326, KPA93328 dhe KPA93329 dhe poashtu urdheron palës përgjegjëse në ankesë M. P. t'i kthehet posedim. KKPK-ka tutje ka urdhëruar se pala përgjegjëse në ankesë apo personi tjetër që e ka uzurpuar pronën duhet ta liroi në afat prej 30 ditës nga marrja e vendimit e nese dështon do të dëbohet forcërisht nga prona. Në të njëjtin vendim KKPK-ja arsyeton se pala përgjegjëse në ankesë nuk ka ofruar provë ligjore që do të provonte pretendimet e saja në pronat e kërkuara.
 9. Pala përgjegjëse në ankesë ka vdekur me 13 maj 2014. B. P. si djalë i tij (njëri nga ta) është trashëgimtar(ët).

Arsyetimi ligjor:

Bashkimi i ankesave:

10. Sipas neni 13.4 i Rregullores se UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Ankesave lidhur me Pronën e Pluajtshme Private, duke Përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-07, Gjykata Supreme mund të vendos mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga KKPK-ja në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i lejon Komisionit të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave në mënyrë që të shqyrtojë dhe merr vendime aty ku ka çështje të njëjta ligjore si dhe të provave.
11. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Civile që janë të zbatueshme në procedura para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Dispozitat e nenit 408.1 në vështrim të nenit 193 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Ligji Nr. 03/L006, në tekstin e mëtejme: LPK) ofrojnë mundësinë e bashkimit të kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efikasitetin e gjykatës dhe zvoglimin e kohëzgjatjes dhe shpenzimeve të procedurës.
12. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm që janë paraqitur ankesat, faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë saktësisht të njëjta në të gjitha lëndët. Vetëm ngastrat, subjekti i së drejtës pronësore që pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat janë të bazuara në deklaratë të

njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjtë.

13. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-227/2014, GSK-KPA-A-229/2014, GSK-KPA-A-230/2014, GSK-KPA-A-231/2014, GSK-KPA-A-232/2014, GSK-KPA-A-233/2014, GSK-KPA-A-234/2014, GSK-KPA-A-235/2014, dhe GSK-KPA-A-236/2014 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-227/2014.

Pranueshmëria e ankesave:

14. Pala ankuese e kishte pranur vendimin e KKPK-ës me 12 Qershor 2014 dhe kishte parashtruar ankesë në Gjykatës Supreme të Kosovës përmes, Agjencisë Kosovare të Pronave, me 11 Korrik 2014.
15. Meqë pala ankuese kishte pranuar vendimin e ankimuar me 12 qershor 2014, dhe kishte ushtruar ankesën me 11 korrik 2014, ai ka ushtruar ankesën mbrenda afatit të paraparë prej 30 ditësh sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, pranda ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës:

Pretendimet e Palës ankuese:

16. Pala ankuese pretendon se Vendimi i KKPK-së ka gabime thelbësore, shkelje të dispozitave procedurale, aplikim të gabuar të së drejtës materialë dhe konstytatim jo të plotë të gjendjes faktike. Ai fillimisht kërkon nga Gjykata Supreme që të ndryshoi Vendimin e KKPK-së dhe që të refuzoj kërkesat e palës përgjegjëse në ankesë si ta pabaza. Ai kërkon pastaj nga Gjykata Supreme, që të shpalli veten jokompetente mbi bazën e gjyqëvarësisë për shkak se ekziston në pritje një lëndë civile C.Nr196/12 në Gjykatën Themelore të Pejës. Pronat e kërkuara janë objekt i asaj procedure dhe se palët janë të njejtat.
17. Pala ankuese paraqet të njejtat dokumente të cilat ai edhe i ka paraqitur para AKP-së në shkallën e parë. Për më tepër, ai ka paraqet kontratën e shitëblerjes në lidhje me ngastrën 91/60. Sipas kësaj kontrate ai e paraqet palën përgjegjëse në ankesë si shitëse.
18. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të caktoi masën e përkohëshme që do të duhej ti urdherohet palës përgjegjëse që të mos e tjetërsoi pronën dhe të mos bëjë ndryshime në librat kadastral deri në përfundim të kontestit
19. Në paragrafet 58 deri 62 të vendimit grupor thuhet se pala përgjegjëse në ankesë kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore dhe riosedimin e pronës. Sekretaria ekzekutive ka gjetur se prona e kërkuar i është nënshtruar rindarjes dhe riparcelizimit në virin 2005 dhe evidenca kadastrale dëshmon se ngastrat 90/1, 91/34, 91/35, 91/36, 91/37, 91/38, 91/39, 91/55, 91/56, 91/57, 91/60 dhe 91/61 evidentohen si pronë e palës përgjegjëse në ankesë. Pala përgjegjëse në kërkesë pohon të ketë marrë autorizim nga pala përgjegjëse në ankesë për të parcelizuar pronën dhe mandej për ta shitur. Pala përgjegjëse në kërkesë e tani pala ankuese ka deshtur të deshmoi se parcelat e përmendura janë shitur në mënyrë të ligjshme.

20. Pala ankuese kundërshton arsyetimin e dhënë nga Komisioni në paragrafet 58-62 të vendimit grupor për arsye se nuk përmendet emri i tij si palë përgjegjëse në kërkesa. Më tej pala ankuese pretendon se me ndarjen e pasurisë së paluejtëshme në ngastra më të vogla, disa prej tyre janë shendrruar në rrugë sipas marrëveshjes së palëve me rastin e shitjes së pronave tjera që nuk janë objekt i këtij vendimi të KKPK-ës. Ai pretendon se aprovimi i kërkesave do të krijonte blerësve të pronave të tjera dhe se urdhëri si i tillë do të jetë i vështirë për përmbarrim.
21. Më tej pala ankuese pretendon se ai ka pasur autorizim nga M. P., pala përgjegjëse në ankesë që të bëjë ndarjen e ngastrave 90/1 dhe 91/1 në njësi kadastrale më të vogla dhe që t'i kryej të gjitha punët administrative në emër të palës përgjegjëse në ankesë. Bazuar në këtë autorizim pala ankuese ka marrë pëlqimin e autoriteteve në Gjakovë/Djakovica dhe ke ndarë parcelat 90/1 dhe 91/1 në 49 parcela të vogla të destinuara për troje ndërtimore.
22. Ngastrat e krijuara rishtas 91/55, 91/56, 91/57 dhe 91/60 sipas pretendimit të palës ankuese edhe pse ato regjistruhen në emër të M. P., palës përgjegjëse në ankesë, ato në fakt janë në pronë të palës ankuese. Ai ka pranuar këto parcela si kompenzim për të gjitha punët dhe shpenzimet e bëra në emër të M.P., palës përgjegjëse në ankesë.
23. Bashkangjitur në ankesë paraqiten dokumentet që kanë të bëjnë me ngastrat që janë shitur me pëlqimin e palës përgjegjëse në ankesë. Për të gjitha këto raste ishin lidhur kontrata dhe dhënat kadastrale ishin ndryshuar.
24. Përfundimisht pala ankuese pretendon se KKPK-ja me vendimin e vet ka shkelur dispozitat e Konventës Europiane mbi të drejtat e njeriut dhe dispozitat e Ligjit për pronësinë dhe të drejtat sendore dhe si i tillë vendimi duhet ndryshuar dhe kërkesat e palës përgjegjëse duhen refuzuar. Pala përgjegjëse në ankesë duhet të pres që çështja të zgjidhet në bazë të vendimit të formës së prerë sipas padisë civile.

Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë:

25. Pala përgjegjëse në ankesë e pohon dhënjën e autorizimit për ndarjen e pronave së kërkuara në ngastra më të vogla, por e mohon kategorisht të ketë shitur pronat e kërkuara ose ngastrat që janë objekt shqyrtimi të vendimit të KKPK-ës.

Arsyetimi i Gjykatës Supreme

26. Lidhur me pretendimin e Palës ankuese se Gjykata Supreme duhet të prishë vendimin e KKPK-ës për mungesë të kompetencës për shkak se një tjetër padi në lidhje me këtë çështje është në pritje, ky pretendim nuk bazohet në ligj për shkak se sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë të zgjidhë këto kërkesa a) Kërkesat pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe b) kërkesat që përfshijnë të drejtat e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, ku pala përgjegjëse në ankesë për të dyja kategoritë nuk është në gjendje t'i ushtrojë të drejta të tilla pronësore.

Ky juridiksion i KKPK-së është ekskluziv sipas nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e në raport me paditë civile tjera të paraqitura para datës 6 tetor 2006 në lidhje me çështjen e kthimit të pronave private të humbura si pasojë e konfliktit apo rrethanave që lidhen me konfliktin.

27. Nga shkresat e lëndës del se pala përgjegjëse në ankesë ka pas të drejtë pronësie mbi pronën e kërkuar dhe se të jejtën e ka humbur si pasojë e konfliktit dhe rrethanave që lidhen me të. Nga ana tjetër dhënja e autorizimit nga pala përgjegjëse në ankesë për palën ankuese për ndarjen e ngastrave nuk mundet që të konsiderohet ndarje vullnetare pas konfliktit, për shkak se autorizimi është i kufizuar për ndarjen dhe nuk përfshin autorizimin që të shesë ngastrat. Fakti që autorizimi nuk përfshin shitjen e pronave të kërkuara në këtë lëndë është theksuar edhe në faktin se emri i palës përgjegjëse në ankesë është ende në kadaster në lidhje me pronat e kërkuara se pala ankuese nuk ka provuar se prona e kërkuar është blerë.
28. Dhënia dhe tërheqja e autorizimit është në vullnetin e autorizim dhënësit sipas përkufizimeve ligjore të LPK-së dhe pala përgjegjëse i ka dhënë autorizim për secilën nga shitjet e realizuara të cilat nuk janë objekt shqyrtimi, por shitja nuk ka fare të bëjë me pronat e kërkuara të cilat janë objekt kontesti në këtë lëndë. Prandaj qëndrimi i KKPK-së se pala ankuese nuk ka paraqitur evidence valide që të kontestoi faktin se prona e kërkuar evidentohet në emër të palës përgjegjëse dhe se e njëjta nuk është tjetërsuar, është i drejtë.
29. Pretendimi palës ankuese se me ndarjen e ngastrave 90/1 dhe 91/1 disa nga ngastrat e kërkuara e kanë ndrruar destinimin dhe tani janë rrugë nuk e ndryshon raportin e pronësisë. Ato ngastra janë ende pronë e palës përgjegjëse në ankesë. Pretendimi se ngastrat e krijuara rishtas 91/55,91,56,91/57 dhe 91/60 edhe pse evidentohen si pronësi e M. P., pala përgjegjëse në ankesë, janë bërë pronësi e palës ankuese si shpërblim për të gjitha shpenzimet dhe shpërblimet e kryera në emër të M. P., palës përgjegjëse në ankesë është i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur me asnjë provë. Nuk ka evidence që ky transferim të ketë qenë pjesë e marrëveshjes së palëve.
30. Në ankesë pala ankuese ka paraqitur kontratën e shitëblerjes së ngastrës 91/60 (numri i lëndës 235/2014) i datës 8 shtator 2005. Në këtë kontrakt ai përfaqëson palën përgjegjëse në ankesë si palë shitëse. Ai nuk ka ofruar arsyetim se pse nuk e kishte paraqitur këtë dokument në AKP. Prandaj, sipas nenit 12.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 kjo dëshmi nuk mundet të pranohet nga Gjykata Supreme në këtë procedurë. Përveç kësaj, kontrata nuk është e verifikuar nga AKP-ja dhe se më këtë kontratë shitëblerjeje nuk është paraqitur autorizimin që e autorizon ankuesin që të përfaqësoj palën përgjegjëse në ankesë në këtë shitje. Prandaj, kjo dëshmi nuk e provon pretendimin se pala përgjegjëse në ankesë ka shitur këtë ngastër.
31. Çështja e kthimit të borxhit që është duke pritur në Gjykatën Themelore të Pejës, padia civile C.Nr196/12, sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 nuk bie në juridiksionin e KKPK-ës për arsye se sipas kërkespadias është mospërmbushja e borxhit ndërmjet palëve dhe jo kërkesa në lidhje me riposedimin ose me vërtetimin e pronësisë.

32. Pala ankuese përsërit tutje të njëjtat pretendime që i ka bërë para KKPK-së. KKPK-ja ka vepruar drejtë kur ka refuzuar këto pretendime. Për më tepër, pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë provë që më parë është marrë parasysh nga KPPK-ja. AKP-ja kishte verifikuar të dhënat cadastrale dhe kishte gjetur se për të gjitha pronat e kërkuara në këtë lëndë nuk kishte ndonjë dëshmi të paraqitur nga Ankuesi që provon se pronat e kërkuara rrespektivisht ngastrat e cekura ishin shitur nga pala përgjegjëse në ankesë.
33. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marr vendim të drejtë, të bazuar në një procedurë të plotë dhe të saktë. Arsyet e tjera të prezentuara nuk mund të shpiejnë në një tjetër vendim. Prandaj, nuk ka shkelje të së drejtës materiale dhe as vërtetim të gabuar ose jo të plotë të fakteve. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pa bazuar dhe Vendimi i KKPK-së i ligjshëm

Këshillë juridike:

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridik.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEXI-i

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it